



ZYRA E PROJEKTEVE
BIRO ZA PROJEKTE – PROJECT OFFICE



RAPORT *janar – dhjetor 2012*

Raporti perfshin :

- *Organogramin e zyres se projekteve dhe detyrat*
- *Organogrami i komunes - Drejtorit komunale dhe komitetet*

Pastaj raporti perfshinë bashkepunimin me :

- *Drejtorit Komunale dhe Komitetet*
- *Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare*
- *Qeverinë e Republikës së Kosovës*
- *Komunitetin Lokal – praticipimet në projekte*
- *Shoqerin Civile - organizatat dhe shoqatat e ndryshme*
- *Të tjera*


*Për informata më të plota rrethë raporteve dhe te dhenave tjera të Zyrës së projekteve mundë të klikoni edhe në web faqen : <http://kk.rks-gov.net/gjilan/>,
linku : projektet – investimet kapitale dhe linku : pasqyrat dhe planet komunale*

Ju falenderojm për mirëkuptim,

Fadil Osmani, Menaxher i zyres së projekteve
E-mail : fadilosmani02@yahoo.com


31 dhjetor ' 2012


Zyra e projekteve funksionon ne kuader te zyres së kryetarit të komunës, merrë detyra dhe urdhra nga kryetari i komunës si dhe raporton për punët e kryera . Skema e orgaizimit :



Zyra e projekteve në kuadër të detyrave bënë përpilimin - përgatitjen dhe arsyetimin e projekteve ideore si dhe konkuron me projekte dhe programe ne programet e Organizatave Nderkomtare (Donatorëve) dhe të gjitha programeve tjera të ofruara për financim të projekteve, bënë seleksionimin e projekteve me priotitet ne bazë të drejtorive dhe tipologjisë së projektit, bënë monitorimin e projekteve, gjetjen e donatorëve për thithjen e investimeve nga donatorët e huaj. Bashkëpunon ngushtë me drejtorit komunale, drejtorit e shkollave, me komitetet perkatse, bashkpunon ngushtë me Qeverinë e Kosovës, Shoqerinë Civile, Ambasadat dhe Zyret Ndërlidhëse te akredituara në Kosovë, me KFOR-in, Policinë e Kosovës me FSK-n, Bashkëpunon ngushtë dhe koordinon te gjitha punët lidhur me projektet me byrot projektuese të kontraktuara nga ana e komunës për përgatitjen e projekteve kryesore, bashkepunon ngushte me zyrën e prokurimit, si dhe kryen të gjitha punët tjera lidhur me projektet, përgatitjen e formularve PIP per MEF, mer pjesë në përgatitjen e buxhetit – për pjesen e investimeve publike, organizon debate publike – rreth investimeve ..

Zyra për projekteve pranon kërkesë nga :





Ndryshe, Kuvendi Komunal i Gjiçanit, ka nëntë komitete :

Dy të obligueshme :

Komitetin për politikë dhe financa dhe

Komitetin për komunitete,

Shtatë të tjera, të cilët përbëhen nga ekspertë të lëmive përkatëse, që nuk është e domosdoshme të jenë nga radhët e këshilltarëve komunalë.

Komitetet kanë zgjedhur edhe kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit e tyre. Kështu, Komitetin për politikë dhe financa, sipas rregullores, e udhëheq kryesuesi i Kuvendit, Izmi Zeka.

Komitetin për komunitete do ta kryesoj Kemal Shahin, Komitetin për arsim – Ejup Haziri, Komitetin për kulturë, rini dhe sport – Tahir Arifi, Komitetin për planifikim dhe urbanizëm – Florina Zymberi, Komitetin për prone, kadastër, banim – Ali Arifi, Komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale – Abdylatif Latifi, Komitetin për shërbime publike dhe emergjencë – Shaqir Shaqiri, Komitetin për zhvillim ekonomik – Elisah Ymeri.

Përbërja e Qeverisë Komunale 2012 :

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit – Bujar Nevzati
 Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale–Xhemajl Salihu
 Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit– Bahrije Mahmuti
 Drejtor për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim – Gani Neziri
 Drejtor i Bujqësisë dhe Pylltarisë – Nazmi Rapuca
 Drejtor për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Nuhi Nuhiu
 Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike - Behar Mehmeti
 Drejtor i Administratës së Përgjithshme – Arben Dubova
 Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – Blerton Ajeti
 Drejtor i Drejtoratit të Inspeksionit - Ismet Hajdini
 Drejtor i Drejtoratit për Rini, Kulturë dhe Sport – Selver Xhelili
 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – Riad Rashiti

Me shumicë votash gjate muajit nëntorë 2011, këshilltarët e Kuvendit Komunal të Gjiçanit kanë miratuar ndryshimet dhe plotësimet në statutin e Komunës, ku kanë themeluar Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik .

Zyra e projekteve në kuadër të detyrave bënë përpilimin - përgatitjen dhe arsyetimin e projekteve ideore si dhe konkuron me projekte në programet e Organizatave Ndërkombëtare (Donatorëve) .

Gjatë vitit 2011/2012, zyra e projekteve ka aplikuar me projekte dhe është duke bashkëpunuar me këto Organizata Ndërkombëtare dhe Institucione tjera financiare :



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA

DEMOCRATIC EFFECTIVE MUNICIPALITIES INITIATIVE
INICIATIVA PËR KOMUNA DEMOKRATIKE DHE EFEKTIVE
INICIJATIVA ZA DEMOKRATSKE I EFEKTIVNE OPŠTINE

Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE) / Democratic Effective Municipalities Initiative (DEMI) të USAID-it në Komunën e Gjilanit ka realizuar keto projekte :

Viti 2011 :

1. Rregullimi i trotuarit nga Qendra e qytetit në drejtim të shkollës fillore “ Abaz Ajeti,
2. Ndrimit publike ne lagjen Dardania I, e cila eshte tenderuar gjate muajit nentor – dhjetor 2011
3. Rregullimi i rrethrotullimit në lagjen Kamnik (Jugu1) procedurat per keto projekte kane filluar te zhvillohen gjatë fundit të vitit 2011 .

Viti 2012 :

1. Ndrimit publike ne lagjen Dardania I, faza e realizimit janar-shkurt 2012, punët janë kryerë nga kompania “Viva Print” vlera e financimit me participim eshte : 15,273 € programi USAID-DEMI, ndersa komuna 4,295.48 €, vlera totale e projektit eshe : 19,568.48 €
2. Rregullimi i rrethrotullimit në lagjen (Iliria – rruga e Presheves) faza e realizimit mars 2012, punëkryesë eshte kompania Magjistrale, vlera e projektit eshte 85,178.75€. Edhe realizmi i këtij projekti eshte bashkefinacim mes Komunes se Gjilanit dhe programit USAID-DEMI.

Me date 1 mars 2012 programi USAID-DEMI promovon fazen e dyte te programit – grante per komunat, ne kete faze ftohen te gjitha komunat e Kosoves te aplikojne me projektet ne kete program .

Komuna e Gjilanit gjate kësaj faze ka fituar dy grante në vlerë prej 60.000\$ të cilat mjete do të dedikohen për realizmin e projektit :

3. Ndërtimi i terenit sportivë – mbrapa shkolles fillore “ Thimi Mitko” në Gjilan

Projekti ka këto karakteristika :

- Emri i projektit : Ndërtimi i trenit sportiv mbrapa objektit të shkollës fillore “Thimi Mitko” Gjilan”
- Numri i kontratës : EPP -1-00-04-00036-00
- Vlera e përgjithshme e kontratës : 81,820.61€
- Vlera e participimit të programit USAID/DEMI : 48,847.64 (pa TVSH)
- Vlera e participimit të Komunës së Gjilanit : 32,972.97 (pa TVSH)
- Punëkryes : sh.p.k “MABB Konstruktion” Gjilan

Projekti “Ndërtimi i trenit sportiv mbrapa objektit të shkollës fillore “Thimi Mitko” Gjilan” e cila bashkëfinancohet nga programi USAID/DEMI dhe Komunës së Gjilanit po realizohet sipas dinamikës së paraparë, me ekzekutimin e punëve në teren jashtëzakonisht jemi të kënaqur .

Gjatë muajit qershor në 25 komuna të Kosovës, përfshirë edhe Gjilanin, ka filluar trajnimi i zyrtarëve komunalë për regjistrimin e pronave të paregjistruara, në kuadër të një programi që USAID dhe SDC, përkatësisht programet DEMI dhe LOGOS po realizojnë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Komunitet

4. *Në këtë program janë të përfshirë tre punëtore të cilët do të angazhohen në sektorin e tatimit në pronë në kohëzgjatje prej 6 muajve (Alije Rrahmani, Elhami Rexhepi dhe Albulena Bllaca)*

Gjatë muajit gusht 2012 duke e parë rëndësinë që ka implementimi i projektit “Regjistrimi i pronave të paregjistruara” si një bazë e mirë për rritjen e të hyrave vetanake përmes zgjerimit të bazës së tatimpaguesve dhe përmbushjes së detyrimit ligjor kemi këkuar nga programi USAID/DEMI të na mbështesë në blerjen e dy (2) pajisjeve GPS dhe me këtë rast ne shprehim gatishmërinë tonë për bashkëfinancim deri në masën 50% .

5. *Blerja e pajisjeve për regjistrimin e pronave të pa regjistruara*

Projekti ka këto karakteristika :

- Emri i projektit : Blerjen e pajisjeve për regjistrimin e pronave të pa regjistruara
- Numri i kontratës : EPP -1-00-04-00036-00
- Vlera e përgjithshme e kontratës : 1,986.20€
- Vlera e participimit të programit USAID/DEMI : 993.10 (pa TVSH)
- Vlera e participimit të Komunës së Gjilanit : 993.10 (pa TVSH)

Gjatë muajit korrik USAID/DEMI është aprovuar projekti për ngritjen e kapaciteteve të Zyres së Mardhënjeve me Qytetarë e cila funksionon brenda Drejtorisë së Administratës së Përgjithëshme :

6. *Emri i projektit : furnizimi me inventarë (tavolina pune, karrike dollap dhe elemente tjera percjellse) për Zyrën e Mardhënjeve me Qytetarë – Drejtoria e Administratës së Përgjithëshme, vlera e projektit “Limani sh.p.k” Prishtinë vlera e projektit 2.335€*

Me datë 31 gushtë - Komuna e Gjilanit ka pranuar donacionin nga USAID-i amerikan, ku përfshihen 17 kompjuter të kompletuar, fotokopjues, projektorë dhe tavolina për këto kompjuter, e që me këtë donacion është kompletuar kabineti për IT, në të cilin projekt edhe Komuna e Gjilanit merr pjesë në bashkëfinancimin e tyre me rreth 20% të mjeteve .

Pas pranimit të këtij donacioni janë krijuar kushtet që të gjitha drejtoritë komunale mund të propozojnë trajnimin e zyrtarëve të tyre në këtë kabinet i cili është krijuar për aftësimin më të mirë të zyrtarëve komunal dhe për nevojat të Komunës në përgjithësi. Komuna e Gjilanit është e para në përdorimin e Teknologjisë Informative, ndaj ky kabinet e forcon edhe më tepër qëndrueshmërinë e asaj që në të ardhmen do të kemi zyrtarët edhe më të përgatitur në këtë fushë.

Qendra e Trajnimit (Kabineti IT) është themeluar për të trajnuar rreth 2.500 nëpunës civilë në mënyrë që ata janë të aftë për t’iu përgjigjur kërkesës në rritje të qytetarëve për forma të avancuara të ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë promovimin e E-Qeverisjes në përputhje me Strategjinë Kombëtare për E-Qeverisjen E-. Komuna harton planet e trajnimit në baza tremujore

Gjatë muajit gusht programi USAID/DEMI në bashkëpunim me Drejtorin e Shërbimeve Publike kemi dorëzuar për aprovim dhe realizim projektin :

7. *Emri i projektit : Ndricimi publikë - Qendra e Qytetit*

Projekti ka këto karakteristika :

- Emri i projektit : Modernizimi i ndriçimit publike – Bulevardi i Pavarësisë
- Numri i kontratës : EPP -1-00-04-00036-00
- Vlera e përgjithshme e kontratës : 152,422.10€
- Vlera e participimit të programit USAID/DEMI : 61,939.30 (pa TVSH)
- Vlera e participimit të Komunës së Gjilanit : 90,482.80 (pa TVSH)
- Punëkryes : n.p “Monten” & n.t.sh “Eling” Prishtinë

Gjithashtu me programin USAID/DEMI jane realizuar edhe keto projekte :

8. *Emri i projektit : Tavolina Ndihmëse Informuese (2 tavolina, 1 karrike, monitori informues me prekje, sirtari i librave (Drejtoria e Adiministrates se Pergjitheshme – QSHQ)*
9. *Emri i projektit : Softveri për trafik (softveri per organizim te trafikut SIM trafik 8) Drejtoria e Sherbimeve Publike*
10. *Emri i projektit : Fuqizimii zyrave per informaimm të Komunës së Gjilanit (printimii materialit informues, llaptop, kamer digjitale, UesBi, monitor informues etj) – Zyra e Informimimit*
11. *Emri i projektit : Eksportimii te dhenave vektoriale per kataster (Drejtoria e Katastrit)*

Rezime : Programin USAID/DEMI gjate kësaj kohe ka arritur keto objektiva po i cekim disa :

1. Forcimi i Administratës Komunale
2. Qendra për Shërbim të Qytetarëve,
3. Fuqizimi i Rolit të Kuvendit
4. Përmirësimi i shërbimeve publike,
5. Zhvillim ekonomik dhe menaxhimi i pronës dhe aseteve komunale
6. Nxitja e pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje



Zyra Ndërlidhese e Komisionit Evropian në Komunën e Gjilanit ka realizuar këto projekte :

Viti 2011 :

1. ***Ndertimi i Bibliotekes Rajonale***, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian shpallë tenderin në web faqen : www.delpn.ec.europa.eu , me numer te references Europe Aid/130900/C/WKS/KOS, projekti ka filluar te realizohet gjate fillimit të muajit nëntor 2011, nga kompania AlBes – Istog, projekti pritet te përfundoj ne fillim te vitit 2013 .
2. ***Ndërtimi i fushës së futbollit (stadionit ndihmës) mbi palestrën e sporteve – Gjilan, qëllimi i projektit*** eshte krijimi i hapësirave për ekipet e futbollit të regjistruara zyrtarisht në Federatën e Futbollit të Kosovës , projekti eshte aprovuar gjate muajit dhjetor 2011. Gjatë vitit 2012 eshte tenderuar projekti në fjalë – gjatë muajit gusht është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit për fillimin e punimeve

Viti 2012 :

Gjatë muajit mars Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka lansuar - Thirjen për projekt-propozime për grante rurale, ky projekt realizohet në bashkëpunim me Organizaten Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ, projekti për „Promovim te Zhvillimit Ekonomik Rural“. Numri i Reference: EuropeAid/132-547/L/ACT/XK, afati i fundit për aplikim është 30 maj 2012 , ne kete program Komuna e Gjilanit ka inkurajuar biznest private për aplikim nga se ka të bëjë me zhvillimin e sektorit të bujqësis dhe blegtorisë .

Gjatë muajit maj Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka lansuar - Thirjen për projekt-propozime për grante programi IPA 2011/022939/02.22.04 / EuropAid/132-792/L/ACT/XK / EU Support for Regional Economic Development, afati i fundit për aplikim është 9 korrik 2012 .

Komuna e Gjilanit gjatë muajit korrik 2012 në bashkëpunim me RDA-në ka përgatitur projektin dhe ka aplikuar në programin EURED-3 për krijimin e Qendrave Turistike ne Regjionin Lindje – Komuna e Gjilanit ne kete projekt eshte lider ndersa komunat tjera jane partere .


Po ashtu ne kete program ka mbështeture edhe organizten joqeveritare KCIC e cila ka aplikuar në kete program me një projekt e cila ka të bëjë me Ruajtjen e Ambientit - Riciklimin .



Embassy of the Czech Republic
in Pristina



Gjatë muajit korrik 2012 ne takime me Ambasaden Çeke e kemi ngriture qeshtjine e zones ekonomike e cila përfshin një hapësirë prej 69 hektarësh, që gjendet në një kënd të rëndësishëm të komunikimit rrugor dhe është një mundësi e mirë për ata që duan të investojnë, jo vetëm nga komunat Gjilan e Artanë, por edhe nga komunat tjera të regionit të lindjes. Zyra e projekteve ka përgatitur shkresen – kërkesen dhe projektin ideor (aplikacioni) si dhe ka aplikuar në Amasaden Çeke për financim të projektit fizibilitetit të zones ekonomike ne fshatin Llabjan .



Projektet e organizates CDI mbesheten financiarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) .

Projektet e organizates CDI mbesheten finciarisht nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), pasi komisioni ne perberje Komune (zyra e projekteve dhe drejtoria e sherbiemve publike) dhe CDI ka identifikuar problemet e infrastruktures ne komunën tonë CDI ka aprovuar në parim realizimin e ketyre projekteve :

- Bresalcë dhe Ponesh - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit
- Pogradjë - Rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimit e impiantit per trajtimin e ujërave të zeza

Me 2 dhjetor 2011, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim për projektin “Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale, faza IV” që do të implementohet në Kosovën Juglindore. Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe drejtori i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovës, Markus Baechler, ndërsa parasheh që Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale të financohet me 2 milionë e 250 mijë CHF nga Qeveria Zvicerane dhe 940 mijë euro nga Qeveria e Kosovës.

Me daten 06/08/2012 kryetari i komunës z. Qemajl Mustafa ka nënshkruar marrëveshjen me CDI zvicerane për rregullimin e projektit të ujësjellësit në Ponesh e Bresalc dhe rregullimin e kolektorit në Pogradhë në vlerë të 1 milion eurove, ku janë të përfshira tri fshatra Poneshi, Bresalci (600 mijë €) dhe Pogradha (400 mijë €) ne kete shume të mjeteve participojnë CDI-së, 45%, Komunës 35 % dhe Qeverisë 25 %. Realizmi i ketyre projekteve do të fillojë këtë vit ndersa do të përfundojnë nga fundi i vitit 2013 .

Gjatë muajit shtatorë 2012 ka filluar procedura e tenderimit e cila është kryer nga CDI, në bazë të procedurave dhe ligjeve në fuqi të Prokurimit Publike për projektin :

- Bresalcë dhe Ponesh - Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit, vlera e kontratës 490,267.00€, punëkryesë “Teuta M” Gjilan
- Pogradjë - Rregullimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimit e impiantit per trajtimin e ujërave të zeza, vlera e kontratës 57,000 €, punëkryesë “Kushtrimi M” Viti

Caritasi i Luxemburgut përmes strategjisë " Zbutja e varfërisë përmes Zhvillimit të Qëndrushëm 2011/2013, programi financohet nga Qeveria e Luxemburgut ka aprovuar projektin me bashkëfinancim me komunën në fshatin Kishnapole e cila me datën 12/12/11 është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit mes paleve .

Komuna e Gjilanit është e përzgjedhur për një investim në vlerë mbi 400 mijë euro, ku komuna e Gjilanit merr pjesë me 30 % të vlerës së përgjithshme në këtë projekt ndërsa pjesën tjetër prej 70% e mbulon "Caritasi", investimet do të bëhen në tri sfera, në edukim, në shëndetësi dhe sektori tjetër është gjenerimi i të hyrave që do të punohet në komunitete. Synojmë të përmirësojmë jetën e këtyre banorëve në sferat e përmendura dhe përveç këtyre i kemi edhe tri tema transversale siç janë përmirësimi i barazisë gjinore, parandalimi i konfliktit dhe mbrojtja e ambientit .

Tabela : obligimet e sipas marrëveshjes e mirëkuptimit :

Sektori	Caritasi i Luxemburgut	Komuna e Gjilanit
Arsimi	123,500.00	37,050.00
Shëndetësi	53,225.00	15,967.50
Gjerimi i të ardhurave	99,145.00	29,743.50
Ambienti	21,800.00	Sipas nevojave
Gjinia	4,675.00	Sipas nevojave
Parandalim konflikti	10,375.00	Sipas nevojave
Punëtoritë	3,739.75	1,121.93
Gjithësejtë	316,459.75	83,882.93
Totali € (vitet 2011/2013)	400,342.68	

Caritasi i Luxemburgut gjatë vitit 2012 ka planifikuar të investoj edhe në sektorin e shëndetësisë, zyra e projekteve ka përgatitur dhe ka aplikuar në këtë organizatë me projektin :

o Renovimi i objektit të ambulantes shëndetësore në fshatin Bresalc

Kuvendi Komunal i Gjilanit – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale në bashkëpunim me Zyren e projekteve kan rekomanduar se komuna mere për obligim të participoj me 30 % të mjeteve financiare në vlerën e kontraktuar të projektit .

Gjatë fillimit të muajit mars Caritasi i Luxemburgut ka ndar për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare(QKMF), në Gjilan, një donacion në vlerë mbi 15 mijë euro, e cila ka të bëjë furnizimin me aparaturë moderne dhe të domosdoshme nga lista esenciale, që në përbajtje ka termometër, tensiometër, stetoskop, peshore, sterilizator oftalmoskop, otoskop etj, me të cilat tash e tutje do të mbulohen të gjitha qendrat e mjekësisë familjare, duke përfshirë edhe fshatrat e komunës sonë.

Gjate muajit korrik 2012 është lidhure kontrata për realizimin e projektit :

o Renovimi i objektit të ambulantes shëndetësore në fshatin Bresalc

Komuna e Gjilanit ka parapare dhe ka ndare mjete për participim me 33,974.11€ të cilat mjete i ka dhene në tri këste, nga ky investim është parapare ndërtimi i kulmit, pjesa e mbulojes para hyrjes, nxemja qendrore duke e përfshirë edhe ndërtimin e kaldatores, lysterjen dhe pastrimin nga jashtë, ndërtimin e detyrës dhe dritareve dhe të gjitha punët tjera të cilat kanë krijuar probleme të shumta në këtë objekt .

Në realizimin e projektit : *Renovimi i objektit të ambulantes shëndetësore në fshatin Bresalc* të gjitha procedurat e tenderimit janë kryer nga ana e Caritasit të Luxemburgut ku kanë marrë pjesë dhe zyrtarë komunal gjatë vlersimit dhe evaluimit të projektit .

Punimet janë kryer nga këto kompani :

- për pozicionin e punëve të vrazhda ndërtimore (kulmi, ndërtimi i objektit të kaldasë , lysterja...) QMF - Bresalc është përzgjedhur ndërmarrja "Çatia" nga Komuna e Malisheves

- b) për pozicionin e punimeve-instalimit të Nxemjes Qendrore në QMF - Bresalc është perzgjedhur ndermarrja "KLIMATERM" nga Prishtina
- c) për pozicionin e punimeve të ujesjellesit dhe kanalizimit në QMF - Bresalc është perzgjedhur SH.P.K. "CENI - COM" nga Gjilani – Zheger

Caritasi i Luxemburgut përmesë strategjisë " Zbutja e varfërisë përmes Zhvillimit të Qëndrushëm" në fshatin Kishnapole ka ndarë për bujqët e këtij lokaliteti :

- a) 400 copë dele për krijimin e 13 fermerëve të rinjë ,
- b) 30 familje kanë përfituar nga 5 koshere të bletëve
- c) Janë kryer trajnime për gratë e këtij lokaliteti për konservimin e turshive – një pjesë e trajnimit është mbajturë në fshatin Krush e Madhe

Gjate muajit shtator 2012 është lidhure kontrata për realizimin e projektit :

o *Renovimi i objektit të ambulantes shëndetësore dhe zyrës së ofiqarisë në fshatin Kishnapole*
Komunal i Gjilanit (Drejtorja e Shëndetësis dhe Zyra e projekteve) ka koordinuar të gjitha veprimet me organizatën e Caritasit të Luxemburgut .

Gjate vitit 2012 jemi të angazhuar që të realizojm edhe projektin :

o *Ndërtimi i objektit të ri të shkollës fillore "Afërdita" në fshatin Kishnapole*
Komunal i Gjilanit (Drejtorja e Arsimit dhe Zyra e projekteve) ka koordinuar të gjitha veprimet me organizatën e Caritasit të Luxemburgut, po ashtu veprimet janë koordinuar edhe me Ministrin e Arsimit për nevojën e participimit në këtë projekt .



Turkish International Cooperation and Development Agency (TIKA)

Turkish International Cooperation & Development Agency (TIKA) – ka marrë për obligim financimin edhe realizimin e dy projekteve :

- o Ndërtimi i Objektit të Medreses "Alaudin" në Gjilan dhe
- o Rregullimi i shtratit të lumit dhe rrjetit të kanalizimit në fshatin Doberqan

Projekti "Ndërtimi i Objektit të Medreses "Alaudin" në Gjilan është në fazën përfundimtare të realizimit, pritet që deri në fund të muajit prill – maj 2012 të kompletohet, sa i përket fazës së ndërtimit , objekti është i përfunduar ,ka mbetur vetëm inventarizimi e mandej objekti do të krijonte kushte të mira për nxënësit e medreses .

Projekti Rregullimi i shtratit të lumit dhe rrjetit të kanalizimit në fshatin Doberqan edhe pse është kontraktuar ende nuk ka filluar edhe pse shumë herë është kërkuar sqarime rreth këtij projekti nuk kemi arritur të sigurojm një informant të tillë .

Gjatë fillimit të muajit dhejtor 2011, Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe drejtori i Fondacionit Ndërkombëtar “Balkan Net”, Jean Stanoevski me seli në Shkup, kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim mes dy administratave të Gjilanit dhe asaj të projektit Balkan Net “Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë në Evropën Juglindore”.

Në kuadër të këtij projekti, do të caktohen ekspertë ndërkombëtarë e kombëtarë, për të siguruar të dhëna të nevojshme dhe përpunimin e tyre për qëllime të realizimit të projektit dhe përgatitjen e studimit.

Studimi do të bëhet për të mbledhur të dhënat për gjendjen e kërkesës për ngrohje për ekonomitë familjare, objektet komunale, bizneset dhe të tjera, gjendjen e konsumit të energjisë, për ekonomitë familjare, komunën dhe bizneset, planin urbanistik në komunën e Gjilanit, përdorimi i objekteve komunale, siç janë zjarrfikësit, kopshtet e fëmijëve, shkollat e të tjera, përdorimi i ndërtesave komerciale, burimet e përdorura energjetike në Gjilan dhe pastaj prezantimi i gjendjes në “work shope”, diskutim me përfaqësuesit e qytetit, identifikimin e qasjeve strategjike për menaxhim të suksesshëm, zvogëlim të shpenzimeve dhe kursim të energjisë dhe definimin e hapave për implementim të këtij projekti.

Nga data 08.10.2012 deri me datën 11.10.2012 është bërë një vizitë studimore në qytetin Tutzing, Bavaria (Gjermani) me temën “MENAXHIMI ENERGIJË KOMUNALE”, Ekipi Komunal po punon në nxjerrjen e strategjise për menaxhimin e fiçences elektrike .




Zyra e projekteve ka përgatitur paramasën edhe parallogarit e projektit të rregullimit të rrethojës për objektet 6 familje Rome të cilat nga pas lufta jetojnë në Shkup - FYROM, që tani deshirojnë të kthehen në Gjilan . Zyra e projekteve me datën 26.10/2009 ka kërkuar nga :

- Drejtoria e Kadastrit dhe Pronës : Të dal ekipi për matjen dhe parcelimin e sipërfaqes së lirë komunale, të cilat dedikohen për ndërtimin e 6 objekteve të komunitetit rom dhe Drejtoria e Urbanizmit – sektori për planifikim : Të angazhojë ekipin – sektorin e planifikimit për përgatitjen dhe planifikimin e hapësirës sipas të dhënave kadastrale dhe të japin pëlqimin dhe lejen urbanistike, ndërtimi i shtëpive është kontraktuar UNHCR dhe si punë kryesore është shoqata “Developing Together “ nga Prishtina .



Komuna e Gjilanit është mirënjohëse për bashkëpunimin në mes Komunës së Gjilanit dhe UN Habitat-it për plotësimin e komponentës së Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban, respektivisht komponentës së Vlerësimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Rrezikshmërisë, dhe identifikimit të projekteve për bashkëfinancim.



Më 21 shkurt 2008 në Prishtinë është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Qeverisë Zvicerane dhe Ministrisë së Energjetikës, për ndërtimin e Trafostacionit 110/20 KV. Ky projekt është dhuratë e Qeverisë Zvicerane për rajonin e Gjilanit . Marrëveshjen e mirëkuptimit kanë nënshkruar Jorg Al Reding – ambasador i Zvicres në Prishtinë, Johachim Rucker – kryeadministrator i Kosovës, Justina Pula-Ministre e Energjetikës në Qeverinë e Kosovës, Qemaj Mustafa - kryetar i Komunës së Gjilanit dhe Remzi Shahini – menaxher i KEK-ut.

Viti 2012 – investimi në trafostacionin energjetik i njohur si Gjilani 5 llogaritet si investim në vlerën më të madhe në rajonin lindje që bashkarishte me Banken Botrore kanë financuar largeperquesin Ferizaj – Gjilan(77 shtylla) dhe Gjilan – Pasjan (35 shtylla) si dhe trafostacionin që kap shumën prej 10.5 mil €, realishte trafostacioni 110/20KV e stabilizon Gjilanin për 50 vitet e ardhshme . Ky projekt do të përfundojë gjatë vitit 2012 dhe për Gjilanin do të thotë shumë sepse, Gjilani me rrethinë do të furnizohet me rrymë kualitative dhe do të ndihmohet zhvillimi i qytetit.



**DANISH INTERNATIONAL DEVELOPMENT
AGENCY (DANIDA)**

Falë donacioneve të Qeverisë Danese – organizates Qeveritare “DANIDA” shkolla e bujqësisë “Arbëria” është pajisur me një laborator, ka serën e vetë, ku nxënësit kryejnë punën praktike, po ashtu, ngritja e një pemishte në sipërfaqe prej një (1) hektari është financuar nga “DANIDA”. Njëherësh, danezët, përmes kësaj organizate, do të investojnë edhe në ndërtimin e shkollës së mesme bujqësore “Arbëria” e cila tani me është kontraktuar dhe është në fazën e realizimit . Ne saje të bashkëpunimit të mirë gjatë muajit gusht “DANIDA” ka shprehur interesim që të investojë edhe në ndërtimin e një sere dhe investime në 1.5 hektar për mbjelljen e hardhise së rrushit dhe fidaneve, komuna ka marrë pjesë pastrimin e terrenit të sipërfaqes së lartpërmendurë .

Zyra e projekteve ka përgatitur projektin dhe i ka dorëzuar Qeverisë Danese – organizates Qeveritare “DANIDA” për realizimin e projektit : Ndërtimi i shtalles për mbajtje lopëve, pikën e përpunimit të mishit dhe qumështit dhe pikën e grumbullimit të pemve dhe perimeve - gjatë muajit korrik projekti është në fazën e tenderit .



**Western Balkans Infrastructure Projects Facility
An EU funded project**

WYG International part of the WYG group
creative minds solve problems



Në bazë të Kornizës për Investime për Ballkanin Perëndimor lancuar nga Komisioni Evropian, Projekti për „Lehtësimin e Projekteve të Infrastrukturës (IPF), nëpërmjet konsulencës WYG International, është duke kryer një studim paraprak për projektin “Zbatimi i masave për efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike”.

Qëllimi kryesor i projektit është që të rrisë efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike në pronësi të komunave: kjo paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimtari të Efikasitetit të Energjisë për Kosovën .

Zyra e projektve ka aplikuar në këtë program ku kemi mare konfirmimin nga kjo organizat se jane perzegjurre keto projekte per financim : shkolla fillore “ Ibrahim Uruqi” në fshatin Bresalcë, shkolla fillore “Skënderbeu” në Përlepnice dhe shkolla e mesme “Zenel Hajdini” Gjilan, po ashu pjese e këtij programi jane te përfshira edhe keto objekte shkollore, shkolla fillore “Ramiz Cërrnica” Cernicë dhe Konvikti i Nxënësve dhe Studenteve – Gjilan



Në Komunën e Gjilanit eshte duke u implementuar projekti "Mbështetjen për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimt për Persona me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës .

Gjatë muajit dhjetor 2011 është publikuar për realizimin ketyre projekteve që përfshinë fazën e dytë që ka të bëjë përmirësimin infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara (si pjerrina, rregullimi i nyjeve sanitare, dyerve etj) të objektet publike : Palestra Sportive, shkolla fillore “Th. Mitko”, “ Rexhep Elmazi”, Teatri i qytetit, gjimnazi “Zenel Hajdini” Çerdheja “Ardhmeria II”, shkolla fillore “ Vuk Karagjiq” në fshatin Kmetovcë dhe Fakulteti i Edukimit, punet jan duke u zhvilluar nga kompania “ MABB Construction” .



CDF (Community Development Fund) është fondacion i pavarur që ka marrë grant nga Banka Botërore për projektin “Gjithë - Përfshirje Sociale dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal”. Një ndër qëllimet kryesore të këtij projekti është zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të reja të punës përmes përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe mikro.

Me qëllim të përkrahjes së tyre, CDF fton ndërmarrësit e ri dhe ekzistues që zhvillojnë bizneset e tyre në Komunën e **Gjilanit, Shtërpces, Ferizajit, Hani i Elezit, Kamenicës, Parteshit, Viti, Ranillukut, Novobërdës dhe Klllokotit** që të aplikojnë për grante për zhvillimin e bizneseve. Qëllimi i granteve është financimi i pajisjeve-mjeteve të punës apo ndonjë trajnimi të specializuar që zhvillon biznesin dhe gjeneron punësim.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Zyra e projekteve ka bere njoftimet – promovimet e këtij projekti ku ne saje te saj shume biznese private dhe iniciativa te ndryshme kan aplikuar ne kete grant, afati i fundit per aplikim ka qen data 14 nëntor 2012 .



Zyra e projekteve ka një bashkëpunim të mirë me këtë projekt i cili është financiar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European, projekti ka pas për qëllim dhe ka krijuar Qendrën e Biznesit e cila ka ndihmuar burrat dhe gratë që aspirojnë për të filluar një biznes të ri, ndërsa njerëzit e bizneseve ekzistuese do të ndihmohen për të rritur ndërmarrjet e tyre me krijimin e një ambienti më të favorshëm të biznesit. Organizata Care Internacional ka arritur te realizoj projektin e grumbullimit, përpunimit dhe paketimit të qumështit të dhisë, kjo organizat ka dhene edhe nje (kamion-llantofriz) per kete pike grumbulluese (pikë grumbulluese dhe përpunuese e qumështit te dhise)

Në fundë të vitit në një ceremoni të organizuar nga organizata CARE, drejtuesit e institucioneve lokale dhe qendrore e ndërkombëtare kanë bërë dorëzimin e certifikatave për 80 fermerë, 11 zyrtarë komunalë, 11 profesorë të shkollës së mesme të Bujqësisë, 80 bletarë si dhe 124 drejtues të bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilët i kanë ndjekur këto trajnime. Me date 31/01/2011 programi CARE International ka përfunduar .

Qëllimi i programit është : Aplikimi i Kornizës për matje të performancës së MFP-së , si pjesë e qasjes së përmirësuar në mbështetje të reformave të MFP-së në nivel lokal .

Punëtorja është dizajnuar për stafin e qeverive lokale, që merret me planifikimin dhe menaxhimin e vlerësimeve të PEFA-s. Ekipa komunale e komunes së Gjilanit pas pjesëmarrjes në trainime bashkërisht me programin PEFA ka përgatitur : RAPORTIN E PERFORMANCËS SË PEFA-së PËR KOMUNËN E GJILANIT, pjesë e këtij programi kanë qenë edhe komunat : Novobërda, Ferizaj, Istog, Pejë, Gjakovë . Programi KOSOVA/PEFA për qeverit lokale financohet nga USAID dhe DIFID

OSCE Organization for Security and Co-operation in Europe OSCE Mission in Kosovo

Gjatë fillimit të muajit shkurt, Kryetarët e Komunave Gjilan, Kamenicë dhe Viti, në një takim në zyrat e OSBE-në në Gjilan, të organizuar së bashku me përfaqësuesit e Kompanive publike "Higjiena", "Hidromorava" dhe KEK, kanë debatuar për mundësinë e reagimit të shpejtë gjatë këtij sezoni në të cilin reshjet e borës janë më të shpeshta si dhe për planin e hapjes së rrugëve në këto komuna.



Asociacioni i Komunave të Sllovenisë (AKS) në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) ka iniciuar idenë për themelimin të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave të mira mes institucioneve të vetëqeverisjes lokale të dy shteteve. Komuna e Gjilanit ka paraqitur letër të interesit që dëshmon se ne jemi të interesuar për fuqizimin e marrëdhënieve mes Komunës së Gjilanit dhe Komunave Sllovene konkretisht Komunës Celje ose Komuna Kranj, ndërsa fusha në të cilën mendojmë të bashkëpunojmë janë : parku industrial & inkubatorët e biznesit – zonat ekonomike, bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitarë, trajtimi i ujërave të zeza – impiante, riciklimi i mbeturinave, partneriteti publiko privat .



Zyrta e projekteve ka aplikuar në Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan – konkretisht në Programin e Kombëve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP – EGB) që implementohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) : Program projekti i Gjenerimit të Punësimit - krijimi i vendeve të punës Asistencës për Praktikant.

- **Qëllimi i programit:**
 - o Në Punësimin e të posa diplomuarve të cilët janë pa përvojë pune, por që janë të regjistruar (lajmëruar) në Qendrën Regjionale të Punësimit në Gjilan
- **Qëllimi i programit:**
 - o UNDP – Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim : është e obliguar të siguroj pagën mujore prej 100 € në xhirollogarinë e praktikantit.

- o KK – Kuvendi Komunal : është i obliguar të siguroj vendin e punës – hapësirën në drejtorit Komunale ku praktikanti do të kryej praktikën dhe të përcjell vijueshmërinë në punë .

Faza e parë e këtij programi ka filluar me datën : 08/02/2012 dhe përfundon me datën 07/08/2012, ku janë duke e kryerë praktiken nëpër drejtori dhe zyra komunale në këtë përbërje :

- Zejnepe Ramushi – Drejtorin e Shërbimeve Publike – Sektori i Financave
- Avni Dervodeli – Drejtoria e Financave – Sektori i Tatimit në Pronë
- Aida Xhemajli – Drejtoria Zhvillimit Ekonomik - Qendra për Regjistrimin e Bizneseve
- Salie Aliu – Zyra për Barazi Gjinore
- Arbenita Arifi – Drejtoria e Sherbiemve Publike

UNICEF in Kosovo

Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës

Zyra e projekteve në bashkëpunim me Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës e përkrahur nga UNICEF, zhvillojn fushatën kundër pirjes së duhanit “Stop Duhanit, fillo frymarrjen”.

Aktivitetet përfshinë : Fushatën e cila do të filloj me një performancë të fëmijëve nga Klubi i Ambasadorëve të Vegjël dhe Aktorëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, të cilët të dielën në Sheshin qytetit / para Teatrit të qyteti/ do të tërheqin një cigare gjigante, do të improvizojnë një ring boksi dhe do të shpërndajnë disa broshura me mesazhe kundër pirjes së duhanit.

Fushata në Gjilan fillon me datë 04.03. 2012, në orën 11.30 dhe përfundon në ora 13.30 , në sheshin e qytetit / para Teatrit / , në këtë aktivitet do të marrin pjesë 45 – 70 fëmijë.

Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës u themelua më 19 nëntor të vitit 1961 me vendimin e Kuvendit Komunal me qëllim të përmbushjes së kërkesave të fëmijëve në lëmin e kulturës, edukimit, sportit dhe rekreacionit.



Zyra e projekteve në koordinim me Zyren e kryetarit të komunës gjatë muajit tetor 2011 ka bërë kërkesë dhe ka dorzuar projektet në Qeverinë e Kosovës për financimin e projekteve – shiko tabelen :

Kërkesë për financimin e projekteve për vitin 2012		
Nr.	Përshkrimi - Emërtimi	Vlera e planifikuar €
1	MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS	8,127,300
2	MINISTRINË E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	4,176,303
3	MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	978,551
4	MINISTRINË E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	1,475,520
5	MINISTRINA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	755,766
6	MINISTRIA E TEGTISË DHE INDUSTRIËS	963,637
#	Totali €	16,477,077

Shenim :

- lista e projekteve (kërkesat) për Qeverinë e Kosovës janë dërguar edhe Deputetëve të Parlamentit të Kosovës të cilët vijnë nga Komuna e Gjilanit .
- lista e projekteve është transparente dhe mund të verifikohen në ZP

Zyra e projekteve në koordinim me Zyren e kryetarit të komunës edhe gjatë vitit 2012 ka bërë kërkesë dhe ka dorzuar projektet në Qeverinë e Kosovës edhe për financimin e këtyre projekteve .

■ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) :

Kjo ministri në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit bashkëfinancin dhe implementon projektet :

- *Vitin 2010/2011*

- Ndërtimi i salles se edukates fizike, Çerdhes per femijë parashkollor dhe ndërrimi i mbulesës së objektit të shkollës fillore “Avdullah Tahiri”, fshati Malishevë .
- Rregullimi i shtratit të Lumit Baja
- Asfaltimi i rrugës fshati Velekincë – Deponia Rajonale

- *Vitin 2012*

MAPL – gjate muajit janar 2012 ka ftuar komunat per aplikim ne programin e Investimeve në Infrastruktura Komunale, Zyra e projekteve ka dorzuar aplikacionet dhe ka bere kerkese dhe ka dorzuar projektet per financim të katër projekteve në vlerë 666,468.67 €. Aplikacionet – projektet janë dorzuar në përputhje të plotë me kërkesën e programit .

Gjatë kësaj faze MAPL ka ndarë mjete për realizmin e dy projekteve :

- Participim në projektin : Asfaltimi i rrugës në fshatin Shillovë në vlerë prej : 95,574.85 €
- Participim në projektin : Rregullimi i shtratit të Lumit Baja në vlerë prej : 57,131.00 €
- Participim në projektin : Rregulli i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Kmetocë : 23,000.00€

MAPL – ka ftuar komunat per aplikim ne programin e Fondi i MAPL-së për Zhvillimin Ekonomik Rajonal - ky fond është krijuar për t’u ndihmuar komunave me aktivitetet e tyre për zhvillim socio-ekonomik, fond është përgjigje e Kosovës ndaj kërkesës për të ofruar bashkë-financim për Grant skemën EURED 2011.

Ndërsa Objektivi i përgjithshëm i këti fondi është : rigjenerimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonet ekonomike.

Zyra e projekteve ka aplikur në këtë fondë me projektin : *Zhvillimi i bujqësisë kusht për zhvillimin ekonomikë*, në këtë projekt jemi partner me Komunën e Parteshit, ku kemi përfituar 70.000€ nga të cilët do të përfitojnë 12 bujqë kultivatorë, 12 sera të montuara dhe të kompletuara dhe 5 sprkatse gruri – projekti implemetohet nga Drejtoria e Bujqësisë së Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Parteshit .

Me date 26/11/2012 ne prani te drejtoreve te bujqesis, kryetareve te komunave, perfaqesuesve te MAPL eshte bere shpërndarja e kultivatorëve dhe paisejve tjera, nga ky projekt kane përfituar disa bujqe te komunes sone (listen e përfituesve e posedon Drejtoria e Bujqësisë, pasi ajo ka bere edhe selektimine aplikacioneve)

Zyra e projektve gjate vitit 2011 ka aplikuar me pesë projekte në programin Masat e Eficences së Energjisë në Shkolla projekt i financuar nga BE, ku qëllimi kryesor i projektit është që të rrisë eficiencën e energjisë në ndërtesat publike në pronësi të komunave: kjo paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë për Kosovën .

Nga pesë projektet që kemi aplikuar janë aprovuar tri projekte :

- shkolla e mesme “Zenel Hajdini” Gjilan,
- shkolla fillore “Ramiz Cërrnica” Cerrnicë dhe
- Konvikti i Nxënësve dhe Studenteve – Gjilan

Gjatë muajit tetor 2012 është nënshkruar Marrëveshja e Mirekuptimit me :

- a) kompanin “INOCSA” e cila ka mbikëqyrjen e projekteve dhe
- b) kompanin “GE.COP.spa” e cila ka punët ndërtimore

Zyra e projekteve ka marrë për obligim nga MAPL që kompanive për mbikëqyrje e projektit dhe punëve ndërtimore të ofroj qasje në vende punishte dhe krijimin e lësirave për kryerjen me sukses të këtyre projekteve .

• **Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) :**

Për vitin 2012, Zyra e projekteve për mes zyres së kryetarit i ka bërë kërkesë për mbështetje financiare MASHT për financimin e këtyre projekteve : Ndërtimi i shkollës fillore “Agim Ramadani” në fshatin Haxhaj, Ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Afërdita” në fshatin - Kishnapole, Ndërtimi i objektit të shkollës fillore „Bajram Curri „ në fshatin - Shurdhan, Rehabilitimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Zhegovcë, Ndërtimi i shkollës fillore në lagjen Kufca e Ulët, Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme të muzikës – Gjilan .

Është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit mesë Rektoratit (Universiteti të Prishtinës dhe Komunës së Gjilanit) për financimin e përbashkët të projektit “Punimi i mbindërtimit të objekti i fakulteteve – Gjilan” realizimin e këtij projekti do ta ekzekutoj kompania “ENGRUP” nga Prishtina në vlerë 113,238.95 € (përfshirë TVSH-në), projekti ka përfunduar gjatë muajit shtator 2012 .

▪ **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) :**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për vitin 2012 ka marrë për obligim të financojë realimin e projektit të Lumit Mirusha – faza II, gjatë muajit korrik është bërë përzgjedhja e kompanisë e cila do të fillojë me realimin e këtij projekti .

Kjo ministri në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit bashkëfinancon dhe implementon projektet :

- “Rregullimi i shtratit të lumit Mirusha - faza e II” është kontraktuar me “Company Bejta Commec” Gjilan në vlerën prej : 3.133.170,66 €
- “Rregullimi i lumit dhe vendosja e Përmendores në “Sheshin e Lirisë” Bresalc” është kontraktuar me “Sh.p.k. “ELBAU” & sh.p.k. “Coneks Group” Gjilan” Gjilan në vlerën prej : 59,941.00 €, MMPH në këtë projekt paricion me 20.000€ në vlerën e kontraktuar të projektit.

▪ **Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) :**

Kjo ministri në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit – Zyren e projekteve kanë nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për financimin dhe realimin e dy projekteve në kuadër të programit Punë Publike – Kosova 2012

- *Rregullimi i parkut në lagjen “Arbëria”-hapësira ish tregu i kafshëve, vlera e projektit : 154,000 €, në realizimin e këtij projekti janë punësuar nga Qendra e Punësimit në Gjilan 36 punëtor (programi Punë Publike – Kosova 2012 i cili zgaje 4 muaj)*
- *Rregullojmë dhe zbukurojmë ambientin jetësor në vendbanimet rurale, vlera e projektit : 57,130€ në realizimin e këtij projekti janë punësuar nga Qendra e Punësimit në Gjilan 32 punëtorë (programi Punë Publike – Kosova 2012 i cili zgaje 4 muaj)*
- *Krasitja e pishave dhe pastrimi i sipërfaqës Livoqi i Eperm, në realizimin e këtij projekti janë punësuar nga Qendra e Punësimit në Gjilan 100 punëtorë (programi Punë Publike – Kosova 2012 i cili zgaje 1 muaj)*

Zyra e kryeministrit – Zyra për Çështje të Komuniteteve :

Zyra për Çështje të Komuniteteve në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit – Zyren e projekteve kanë nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për financimin dhe realimin e këtyre projekteve :

- *Ndërtimi i dy shtëpive për raste sociale në fshatin Shillovë, vlera e projektit 40.554 € (nga ky projekt kanë përfituar (familja Bozanovic Zoran 9 anëtarë dhe Tasiq Trajko 6 anëtarë) projekti ka përfunduarë gjatë muajit tetor 2012*
- *Ndërtimi i terenit sportivë në fshatin Kmetovcë , vlera e projektit 58,000€, projekti është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj deri në fund të vitit kalendarik.*
- *Renovimi i kishës në fshatin Cërrnicë, vlera e projektit 22.000€, projekti është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj deri në fund të vitit kalendarik.*

▪ **Ministrinë e Puneve të Mbrendshme (MPB) :**

Edhe gjatë vitit 2012, procesi i riatdhesimit paraqet një sfidë serioze për Kosovën dhe komunat e saj, kur dihet se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të cilët kthehen nga vendet e treta, nuk e kanë të rregulluar problemin e strehimit, sipas disa statistikave, Gjilani është komuna e tretë në Kosovë, për nga numri i atyre që do të kthehen.

Komuna e Gjilanit – Zyra për komunitet dhe kthim dhe Komitetit për Riatdhesim ka të dhënat rrethë financimit të projekteve dhe ndihmave tjera në procesin e Riatdhesimit/ Zyra e projektve nuk ka pasur çasje në këto projekte dhe nuk posedon të dhëna)

Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve (MKK) :

Komuna e Gjilanit – Zyra për komunitet dhe kthim ka të dhënat rrethë financimit të projekteve në Komunën e Gjilanit / Zyra e projektve nuk ka pasur çasje në këto projekte dhe nuk posedon të dhëna)

▪ **Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) :**

Kjo ministri në bashkëpunim me Komunen e Gjilanit financon dhe implementon projektet :

- *Renovimi i palestrave ekzistuese në Qendrat Regjionale: Lot 1- Palestra sportive “Bashkim Selishta”,Gjilan, numri i prokurimit : 207 12 069 5-2-1, data e mbylljes së tenderit 08/08/2012, procedurat e prokurimit kryhen nga ana e MKRS .*
- *Intervenimet emergjente në objektet e trashigimisë kulturore në Qendrat Regjionale të Kosovës (lot 5 – Gjilan) numri i prokurimit : 207 12 095 5-2-1, procedurat e prokurimit kryhen nga ana e MKRS, vlera e kontratës është : 26,628.00€*

▪ **Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë (MTI)**

Zyra e projekteve permes Zyres së Kryetarit i ka bere kerkese Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (Agjencia për Mbështjen e NVM-ve) që zona e përbashkët ekonomike e cila gjindet në zonën kadastrale – Novobërdë, në vendin e quajtur Koznica (Llabjan) që te krijohet në përputhje dhe konform Ligjit për Zonat Ekonomike, Nr. 03/L-129, po ashtu është kërkuar mbështetje financiare për rregullimin e infrastrukturës të zonës ekonomike në fshatin Llabjan e cila është parapare te ndërtohet në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të kryetareve të komunave dhe vendimin e asambleve komunale te komunave të lartpërmendura .

▪ **Qeveria e Kosovës – Rishkimi i Buxhetit :**

Gjatë muajit korrik Qeveria e Kosovës ka bere rishkimin e buxhetit 2012, nga rishkimi i Buxhetit Komuna e Gjilanit ka përfituar këto projekte :

- Asfaltimi i rrugës Pogragjë – Llovcë – data e publikimit të tenderit nga Ministria e Infrastrukturës 07/09/2012 data e mbylljes së tenderit 17/10/2012, me datën 16/11/2012 eshte shaplle perfituesi i ketij projekti qe është kompania “Zuka Commerce” Gjilan, vlere e projektit eshte : 468,561.64 €
- Rregullimi i trotuarit në rrugën “ Mulla Idrizi” Gjilan, vlere e projektit 15,887 €
- Pllaka përkujtimore në fshatin Llashticë, vlere e projektit 9,971 €

Këto projektet janë bashkëpinim i Zyrës së kryetarit (Zyrës së Projekteve) me Deputet e Parlamentit të Kosovës nga Komuna e Gjilanit .

Duke u bazuar në konceptin e kreut të Komunës z.Qemajl Mustafa që transparenca dhe llogaridhënia të jetë e mjaftueshme për të gjitha OJQ-të, ne si zyrë e projekteve kemi ndërtuar një partneritet të ndërsjellë ku së bashke me OJQ kemi identifikuar dhe kemi sensibilizuar çështjet jetike për Gjilanin. Në veçanti zyra e projekteve ka përkrahur ato OJQ që me programet e tyre, me ndikimin e tyre dhe sensibilizimin e problemeve tona të përbashkëta na kanë nxitur me ide dhe sugjerime për të qenë më afër qytetarit.



Duke pasur parasysh ndikimin që ka treguar për vitet që nga pasë lufta Klubi i Gazetarëve “Beqir Musliu” i cili me debatet e organizuara ka ngjallur jetën politike, ekonomike, arsimore dhe kulturore në qytet dhe Anamoravë, si zyre e projekteve u kemi ofruar në disa raste zyrtarët tanë të cilët kanë qenë pjesë e paneleve. Klubi i Gazetarëve “Beqir Musliu” donator të vetëm e ka Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung me seli në Prishtinë, kurse debatet e organizuara nga ky Klub për komunën kanë qenë shumë të mirëseardhura.

Madje shpesh në këto debate ka pasur edhe kritika në adresë të pushteti komunal të cilat neve vetëm sa na kanë ndihmuar për ta përmirësuar imazhin dhe transparencën karshi qytetarëve.

Nga arkiva e zyrës sonë kemi evidentuar debatet që ka mbajtur ky Klub për vitin 2012

➤ **Temat e debatit :**

- o Demokracia e brendshme dhe transparenca tek partitë politike,
- o Sa janë të kënaqur qytetarët me shërbimet shëndetësore
- o ATK përballë bizneseve dhe taksapaguesve gjilanas
- o S`a është cilësor arsimi i mesëm dhe universitar në Anamoravë
- o Si të reduktohet zhurma në qytetin e Gjilanit



Këshilli Qendror i Veprimit Rinor i Kosovës
Central Council of Youth Action of Kosovo
Centraalni Savet Omladinske Delatnosti Kosova

Gjatë muajit shkurt 2011, në sajë të bashkëpunimit të mirë të Këshillit Qëndrorë Rinor me shume organizata partnere, ne Gjilan kan qëndruar Kryesia Qendrore e Rinisë nga Shteti i Turqisë .

Kryesia Qendrore e Rinisë së Shtetit të Turqisë i kanë bërë vizitë zyres së projekteve ku janë njoftuar me problemet në shumë sektorë e sidomos në sektorin e rinisë dhe kulturës ku janë paraqit edhe prioritett në këtë sferë.

Këshillit Qëndrorë i Veprimit Rinor i Kosovës në bashkëpunim me IpCenter nga Austria kan filluar pregatitjet per organizmin e trajnimeve per Rinin Gjilanas nga sektore te ndryshem, me konkreteishte sipas nevojave te aplikanteve. Zyra e projekteve ka dhen enje kontribute në njoftimin e të rinjve për aplikim në këtë program po ashtu ka ndihmuar të rinjtë në aplikim edhe pse barrenkryesore të këtij organizmi e ka mbajtur KQVR qe menagjohet nga z. Mensur Morina.



Organizat Jo qeveritare “ Agro - Eko “ gjatë këtij viti ka implementuar projektin “Mjedis të pastër për jetë të shëndoshë – Clean Enveronment for Healthy Life” , projekti është financuar nga Ambasada Amerikane në vlerë 14.000\$ e cila ka për qëllim që të realizoj projektin sa më mirë dhe sipas marrëveshjes, organizon vullnetaret të pastroj ambientin, organizon ditën e hapjes, vendos logot e shoqatës dhe donatorit dhe promovon – idenë e ruajtjes së mjedisit .



**AKSIONI KUNDËR DHUNËS
DHE NDËRTIMI I PAQES
ANP –GJILAN**

Organizat Jo qeveritare “Aksioni Kundër Dhunës dhe Ndërtimi i Paqës - ANP” gjatë këtij viti ka implementuar projektin : *“Rrjetëzimi regjional i të rinjve kundër diskriminimit në Ballkanin Perëndimor”* po ashtu kjo organizat ka mbajtur një sër trajnimesh me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të të rinjve për identifikimin e formave të diskriminimit në shoqëri . Projekti *“Rrjetëzimi regjional i të rinjve kundër diskriminimit në Ballkanin Perëndimor”* ka për qëllim të fuqizojë dhe të nxisë të rinjtë e regjionit të Gjilanit që të të zbulojnë mekanizma të rinjë për krijimin e një ambienti paqësor, duke promovuar kulturën e padhunshmërisë dhe tolerancës, si dhe dërgimin e një mesazhi të fuqishëm te opinionet e tyre përmes aktivizmit të tyre në luftimin e dukurisë së diskriminimit.

Kjo do të kontribuojë që të rinjtë përmes aktiviteteve kreative dhe artistike t’i shprehin qëndrimet dhe opinionet e tyre për format ekzistuese të diskriminimit në shoqëri, si dhe të ndërmirren hapa të nevojshëm për zgjidhjet e mundshme.



Duke pasur parasysh gjendjen ekonomike mjaftë të vështirë të një numri të madhë të familjeve të cilat jetojnë në varfëri të skajshme, Qendra Rinore në Gjilan (QRGJ) ka marr iniciativën për të organizuar një ankand humanitar me piktura të cilat janë punuar nga piktorët e rinjë të Q.R.GJ, si dhe nxënësit e shkollës së mesme të dizajnit, të cilët kanë shprehë dëshirë të kontribuojnë në këtë drejtim, moto e këtij aktiviteti është “Ne mundemi pse të mos ndihmojmë”, mjetet të cilat grumbullohen gjatë ankandit iu dedikohen familjeve me gjendje të rëndë ekonomike ku kryesisht janë gratë kryefamiljare.

Zyra e projekteve ne saje te bashekpunimit te mire me komunitetin lokal, komunitetin e biznesit dhe organizatat tjera te cilat veprojnë ne Komunen e Gjilanit ka përgatitur Marreveshje te Mirekuptimit nga te cilat jane krijuar te hyra ne vlere prej 10,232.20 €.

Zyra e projekteve bene pergatitjen e marreveshjeve te mirekuptimit, ndersa te gjitha marreveshjet nenshkruhen mes paleve te interesuara per participim ne rregullimin e infrastruktures dhe kryetarit te komunes .

Skema e partipimeve 2012

Nr.	Paricipimi – emri dhe te dhena tjera	Data e faktures	€- shuma e pageses
01	SH.P.K “MOEA” Kravaricë - Ndërtimi i largpërçuesit (LP)10(20) KV me gjatësi L=2.8 km dhe TS 10/04 KV, 400 KVA në fshatin Kravaricë	16/07/2012	8,232.20
02	Rregullimi i trotuarit te kombinati i duhanit në drejtim të shkollës “Abaz Ajeti”	04/09/2012	2,000.00
Shuma e përgjithëshme : €			10,232.2

Sqarim :

- *Vlerat e projekteve ne kete raport jane vlera te cilat Zyra e projekteve i ka fituar përmes konkurrimit në Organizata Ndërkombetare, Qeverin e Kosoves dhe institucione tjera buxhetore, ndërsa vlera e projekteve të kontraktuara mundë të mos përputhet sepse projektet i nëshetrohen një konkurrence të parparë me Ligjin e Prokurimit Publikë të Kosovës .*

Lista e Projekteve te realizuara dhe atyre në proces gjatë vitit 2012

Nr.	Përshkrimi i projekteve	Vlera e kontratës €
1	Rreg.i lumit dhe vendosja e përmendores në "Sheshin e Lirise" - Bresalc	59,941.00
2	Punimi i pllakes përkujtimore në fshatin Llashtice	10,885.00
3	Hapja e trasesë së rrugës nga kthesa e Përlepnices deri në hyrje të fshatit	9,944.00
4	Ndërtimi i largpërçuesit në fshatin Kravaricë	21,232.20
5	Rregullimi i trotuarit te Kombinati i duhanit përgjat rrugës të sh.f. A.Ajeti	18,307.00
6	Ndërtimi i Urës në fshatin Cërnicë lagja Gërgajve	9,996.76
7	Renovimi i kishes në fshatin Cërnicë	23,033.00
8	Rregullimi i shtratit të lumit Mirusha - Faza e II-të	3,133,170.66
9	Mirëmbajtja verore e rrugëve	208,916.98
10	Zbukurimi i ambientit jetësor në vendbanimet rurale	36,194.00
11	Rregullimi i parkut në lagjen Arbëria	148,196.69
12	Ndërtimi i një shtëpie - rast social	8,851.15
13	Ndërtimi i dy shtëpive -raste sociale në fshatin Shillovë	36,176.48
14	Sanimi i rrugëve në qytet	9,935.00
15	Rregullimi i nxemjes qendrore te aneksi "Ardhmeria II"	9,304.62
16	Kompletimi i disa projekteve në rregullimin e infrastrukturës	38,023.24
17	Rregullimi i terenit ndihmës te stadiumi i qytetit	9,904.00
18	Punimi i pjesës së mbetur të rrethojës metalike në fshatin Dobërçan	5,781.10
19	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	173,371.55
20	Rregullimi i infrastrukturës në fshatin Shillove - vazhdim projekti	95,574.89
21	Pastrimi dhe heqja e drunjve te pishat e Stanishorit	12,580.00
22	Ndërtimi i rretherrrotullimit në udhëkryqin Lagjen ILIRIA	85,178.75
23	Mirëmbajtja teknike e objekteve komunale	304,774.42
24	Rregullimi i terenit sportiv në lokacionin afër shk.fillore "Thimi Mitko"	81,820.42
25	Rregullimi i fushës së sportit në fshatin Kmetoc	74,827.89
26	Ndriçimi në lagjen "Dardania I "	19,568.00
27	Ndriçimi publik- qendra e qytetit Gjilan	152,420.00
28	Stadioni ndihmës – pjesa mbi palestren e sporteve	600,000.00
29	Ujesjellësi në fshatin Bresalc dhe Ponesh	490,000.00
30	Kanalizimi në fshatin Pogragjë	57,000.00
31	Renovimi i QMF-së në Bresalc	83,974.00
32	Renovimi i QMF-së në Kishnapole	40,000.00
33	Ndërtimi i shtallës së lopëve, objekteve përcjellëse dhe depos ftohëse për pemë dhe perime	150,000.00
34	Asfaltimi i rrugës Pogragjë - Llovçë	486,561.00
TOTALI €		6,705,443.80